



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
РЕПУБЛИКА Е МАКЕДОНИСЕ СЕ

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 97-të të mbajtur më 27.12.2023, ka miratuar sa vijon.

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-5201/1 nga 06.11.2023, me pretendime për parregullsi në procedurën gjyqësore, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent, për arsye se ka gjykuar se janë duke vepruar organet kompetente.

Lënda me numër 12-5201/1 nga 06.11.2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Më datë 06.11.2023, një parashtrues i njohur ka bërë denoncim me pretendime për parregullsi në procedurë gjyqësore dhe është konstatuar lënda me numër 12-5201/1, datë 11.06.2023.

Në denoncim, parashtruesi deklaroi se është duke e paraqitur kërkesën për shkak të një mosmarrëveshjeje gjyqësore midis parashtruesit dhe personit ----- . Sipas pretendimeve në denoncim, në çështjen gjyqësore është kërkuar që prona në fjalë të ketë statusin e barrës dhe para se të merret vendimi është liruar nga barra dhe në ndërkohë është tjetërsuar. Në vijim thuhet se kundër vendimit të gjykatës është bërë ankim dhe është kërkuar të kontrollohet nëse

ka pasur ndikim nga pala tjetër në vendimin e gjykatës. Përkatësisht, denoncimi tregon për një dokument të pavlefshëm dhe mungesë noteriale, duke pasur parasysh se pala po e dërgon atë nga jashtë dhe për të njëjtën është njoftuar Oda e Noterëve dhe Ministria e Drejtësisë. Thuhet se për shkak të një sërë keqpërdorimesh është ndryshuar pronësia në kadastër, për çka parashtruesi nuk ka mundësi t'i arkëtojë kërkesat e tij pas aktgjykimit të formës së prerë në kontest.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja ka konstatuar se në rastin konkret procedura është duke u zhvilluar pranë organeve kompetente administrative dhe gjyqësore, për këtë arsye ka vlerësuar se nuk ka elemente për veprim kompetent dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar:

- parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: B:K:SH

Miratoi: S.P.D anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHETËTOR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**

**Nënkryetar,
Софка Пејовска Дојчиновска**